



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM

Nr. 113, Datë 29.03.2021

PËR

NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 97, DATË 17.03.2021, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të neneve 61, 68, 88 shkronja “a” dhe “c”, 272 pika 3, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenit 5 pika 3 dhe 6, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, bazuar në kërkesën e gjyqtarës Anila Karanxha dhe në materialet e dërguara nga Shkolla e Magjistraturës,

VENDOSI:

1. Të shtojë në listën e pjesëmarrësve të gjyqtarëve në programin e formimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, për periudhën prill 2021 – korrik 2021, të miratuar me vendimin nr. 97, datë 17.03.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjyqtaren {...} në aktivitetet trajnuese, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, pjesë përbërëse e tij.
2. Gjyqtarja e përfshirë në listën sipas pikës 1 të këtij vendimi, merr pjesë në aktivitetet trajnuese, në përputhje me rregullat e parashikuara në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.
3. Gjyqtarja duhet të marrë masa organizative për të mos penguar ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore, në ditët që do të marrë pjesë në aktivitetet trajnuese.
4. Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magjistraturës dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

{...}, për periudhën prill-korrik 2021

1. Aktivitet trajnues datë 15-16 prill 2021, me temë “Standardet ndërkombëtare të punës (SNP) në praktikën gjyqësore”.

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni	Institucioni
8.	{...}	Gjyqtare	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

2. Aktivitet trajnues datë 7 maj 2021, me temë “Ankimi kushtetues individual – risitë e kontrollit kushtetues post reforme në lidhje me të drejtat procedurale dhe substanciale të individit”.

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni	Institucioni
7.	{...}	Gjyqtare	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

3. Aktivitet trajnues datë 1-2 qershor 2021, me temë “Kriteret ligjore dhe procedura specifike e aplikimit të “Lirimit me kusht” të të miturit në konflikt me ligjin. Dallimet në zbatimin e Institutit të “Lirimit me kusht” ndaj të dënuarit madhor dhe të miturit në konflikt me ligjin. Zëvendësimi i pjesës së pakryer të dënimit si një risi në legjislacionin penal të drejtësisë për të mitur. Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë. Lirimi me kusht i të dënuarve me burgim të përjetshëm (Standardet e GJEDNJ-së); aspektet krahasimore me vendet e tjera”.

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni	Institucioni
32.	{...}	Gjyqtare	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

4. Aktivitet trajnues datë 7 qershor 2021, me temë “Pavlefshmëria e akteve të procedurës penale dhe reforma e procedurës penale. Probleme të praktikës gjyqësore”.

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni	Institucioni
23.	{...}	Gjyqtare	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

5. Aktivitet trajnues datë 5 korrik 2021, me temë “Disponimet e gjykatës rishikuese në gjykimin civil dhe administrativ dhe rigjykimi pas prishjes së vendimit në gjykimin civil dhe administrativ”.

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni	Institucioni
27.	{...}	Gjyqtare	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë